



## VAKSINIMI COVID-19

# Informacion për të rriturit me sëmundje kronike dhe personat e moshës 65 vjeç e lart

### Unë kam një sëmundje kronike.

### Unë jam 65 vjeç ose më i madh.

COVID-19 është i rrezikshëm për ju.

Prandaj rekomandojmë: Të vaksinoheni.

Konsultohuni me mjekun tuaj.

### Pse është i rrezikshëm COVID-19 për mua?

COVID-19 mund të ketë pasoja të rënda dhe madje shumë të rënda për ju. Për shembull gulçim në rastin e pneumonisë. Pastaj ju duhet oksigjen dhe duhet të shkoni në spital. Mund t'ju duhet shumë kohë për tu rikuperuar. Nëse përkeqësoheni nga COVID-19, ju duhet të trajtoheni në Njësinë e Kujdesit Intensiv. Ju mund të keni nevojë për frymëmarrje artificiale. COVID-19 mund të dëmtojë edhe organet e tjera dhe ju mund të vdisni nga kjo.

### Për cilat sëmundje kronike Zyra Federale e Shëndetit Publik (BAG) rekomandon vaksinimin nga COVID-19?

Ne rekomandojmë vaksinim në rast të:

- Tensionit të lartë të gjakut
- Sëmundjeve kardiovaskulare
- Diabeti
- Sëmundjet kronike të frymëmarrjes
- Sëmundje kronike të mëlçisë, duke përfshirë cirrozën
- Insuficiencë renale
- Kanceri
- Sëmundje dhe terapi që dobësojnë sistemin imunitar
- Shumë mbipeshë

Personat me gjendjet e mësipërme janë më të rrezikuarit për sëmundshmëri të rëndë nga COVID-19. Njerëzit me këto sëmundje duhet të vaksinohen me përparësi.

Nëse jeni një nga njerëzit me rrezikshmëri më të lartë me sëmundje kronike: Mjeku që ju trajton do të rekomandojë urgjentisht vaksinimin tuaj sa më shpejt të jetë e mundur.

### Është vaksinimi efikas dhe i sigurt?

Çdo vaksinë ka nevojë për miratim dhe rekomandim në Zvicër. Për ta bërë këtë, ajo duhet të plotësojë standarde të larta për sigurinë, efikasitetin dhe cilësinë. Agjencia Zvicerane për Produkte Terapeutike, Swissmedic, ka ekzaminuar dhe miratuar me kujdes vaksinën kundër COVID-19. Ajo është e sigurt dhe efikase. Dhjetëra mijëra njerëz tashmë kanë marrë vaksinën gjatë punës kërkimore. Është gjithashtu e sigurt dhe efikase tek të moshuarit edhe me sëmundje kronike.

Disa milion njerëz janë vaksinuar me këto vaksina që nga miratimi. Deri më tani nuk ka asnjë anomali në lidhje me efektet anësore të rënda gjatë hulumtimit ose programeve të vaksinimit. Profesionistët vazhdojnë të monitorojnë sigurinë dhe efikasitetin e vaksinës.

Në përgjithësi: Rreziku i efekteve anësore serioze pas vaksinimit është shumë më i vogël se rreziku i përparimit serioz të sëmundjes pas infektimit nga koronavirusi.

### Ku dhe kur mund të vaksinohen?

Qeveria federale ka hartuar një strategji dhe rekomandime për vaksinimin. Kantonet janë përgjegjëse për vaksinimin. Zbuloni se cilat grupe njerëzish mund të vaksinohen aktualisht dhe ku, në faqen e internetit ose në linjën e informacionit në kantonin tuaj [www.foph-coronavirus.ch/cantons](http://www.foph-coronavirus.ch/cantons) (anglisht). Ose pyesni mjekun apo farmacistin tuaj.

[www.foph-coronavirus.ch/vaccination](http://www.foph-coronavirus.ch/vaccination)

Linja telefonike e vaksinimit ndaj COVID-19: 058 377 88 92



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Departamenti Federal i Punëve të Brendshme EDI  
Zyra Federale e Shëndetit Publik BAG

Albanisch / albanais /  
albanese / shqip



Më shumë  
informacion

**KËSHTU  
MBROHEMI NE.****Kush nuk duhet të vaksinohet?**

Ne nuk u rekomandojmë vaksinimin COVID-19 këtyre njerëzve:

- Njerëzve me alergji të rëndë të konfirmuar ndaj cilitdo përbërës të vaksinës (veçanërisht glikolit të polietilenit PEG).
- Fëmijëve dhe adoleshentëve nën 16 vjeç. Deri më tani nuk ka të dhëna për vaksinimin në këtë grupmoshë.

Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për vaksinimin gjatë shtatzënisë. Aktualisht nuk rekomandojmë vaksinimin e përgjithshëm të grave shtatzëna. Në rastin e disa sëmundjeve kronike me rrezik më të lartë të sëmundjes së rëndë Covid 19, vaksinimi mund të jetë ende i dobishëm. Nëse jeni shtatzënë dhe keni një sëmundje kronike, ju lutemi të konsultoheni me mjekun tuaj.

**Ku mund të gjej më shumë informacion?**

Informacione të mëtejshme mbi vaksinimin nga COVID-19 mund të gjenden në faqen e internetit të BAG: [www.foph-coronavirus.ch/vaccination](http://www.foph-coronavirus.ch/vaccination) (anglisht) Ose pyesni mjekun tuaj. Ose në farmacinë tuaj.

[www.foph-coronavirus.ch/vaccination](http://www.foph-coronavirus.ch/vaccination)

Linja telefonike e vaksinimit ndaj  
COVID-19: 058 377 88 92



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Departamenti Federal i Punëve të Brendshme EDI  
Zyra Federale e Shëndetit Publik BAG

Albanisch / albanais /  
albanese / shqip



Më shumë  
informacion